



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1030/Prot  
3

Tiranë, më 9.11.2016

VENDIM

Nr. 72, datë 9.11.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Hotel "Sky" sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhërit Nr. 206, datë 28.09.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 03.10.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Hotel "Sky" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Hotel "Sky" sh.p.k. Tiranë.

Gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, grupi i kontrollit u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.206, datë 28.09.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ", që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk e ka kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet në të cilat ushtron aktivitet, nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Konstatohet se kontrolluesi nuk ka marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave në lidhje me mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të

jashtme, nëpërmjet këtij sistemi. Kontrolluesi nuk disponon një rregullore në lidhje me funksionimin e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).

3. Kontrolluesi mban një fotokopje të pasaportës në momentin e regjistrimit të klientit në hotel dhe kjo ruhet për një periudhë gjashtë mujore.
4. Kontrolluesi disponon një "Formular regjistrimi" (check-in form) për klientët, e cila përmban të dhëna personale të klientit e shoqëruar me fotokopjen e dokumentit identifikues, kartë identiteti apo pasaportë. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave në lidhje me qëllimin e përpunimit dhe nuk merr pëlqimin e klientit me shkrim, në momentin që kryen një kopje të dokumentit identifikues (pasaportë ose kartë identiteti).
5. Kontrolluesi nuk aplikon Deklaratë Konfidencialiteti me punëmarrësit.
6. Kontrolluesi nuk ka rregullore të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Konstatimet e mësipërme përbëjnë shkelje të nenit 5, 6, 18, 21, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, "Për Mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Kontratë individuale pune;
- Formulari i regjistrimit të klientëve (Check-in form);
- Fotografi të ambienteve;
- Ekstrakt i QKR-së (QKB);
- Kontratë me palë të tretë për sigurinë fizike të ambienteve.

Duhet theksuar se, ky kontrollues ishte bashkëpunues me grupin e kontrollit.

Në përmbyllje të procesit administrativ, u hartua dhe u lexua procesverbali në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit Hotel "SKY" sh.p.k., Tiranë.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se janë në proces të marrjes së masave për të përmbushur konstatimet e grupit të kontrollit dhe do i paraqesin ato para seancës dëgjimore.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", datë 30.04.2015, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 25.10.2016, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar. Përfaqësuesit e kontrolluesit nuk u paraqitën.

Zyra e Komisionerit, sjell në vëmendje të kontrolluesit Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë se:

1. Mos plotësimi i Formularit të Njoftimit është një shkelje flagrante, pasi është procesi fillestar i mbrojtjes së të dhënave personale, dhe për mos përmbushjen e këtij detyrimi, kontrolluesi penalizohet sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "d", të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, i cili shprehet: *"...kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë"*.
2. Mungesa e një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, do të thotë mungesë masash paraprake, me qëllim shmangien e kundravajtjeve. Mungesa e rregullores është një shkelje e parashikuar në Ligjin, Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, konkretisht në nenin 27 të tij, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "dh" i cili shprehet: *"...kontrolluesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë"*.
3. Mungesa e tabelave informuese, në ambientet ku instalohen dhe veprojnë kamerat e vëzhgimit (CCTV), është shkelje e nenit 18 të Ligjit, Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "b", i cili shprehet: *"...kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 300 000 lekë"*.

Grupi i hetimit konstatoi se, gjatë ushtrimit të aktivitetit të kontrolluesit *Hotel "Sky" sh.p.k.* Tiranë, ndër format e ndryshme të grumbullimit të të dhënave manuale dhe elektronike, ai grumbullon dhe ruan të dhëna nëpërmjet kopjimit apo skanimit të dokumentave identifikuese të klientëve, duke krijuar një *data base* elektronik të përhershëm. Ky grumbullim në këndvështrim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën shkelje të neneve 5 dhe 6 të tij, pasi qëllimi fillestar mbi shërbimin e hotelerisë në shumicën e rasteve finalizohet me pagesën nga ana e klientit për shërbimin e ofruar, parashikuar kjo dhe në Kreun III, "Të dhëna të detyrueshme", pika 4 e Udhëzimit Nr.10, datë 06.09.2011, për "Përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere" i cili shprehet:

*"Hoteli ruan të dhëna personale vetëm për një periudhë kohore që është e nevojshme me qëllim ofrimin e rezervimit të tij dhe strehimit apo shërbimeve të tjera të kërkuara. Pas mbarimit të kësaj periudhe, të dhënat personale ruhen vetëm për qëllime të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të ligjshme të hotelit, veçanërisht nëse shërbimet hoteliere janë objekt i procesit gjyqësor, ose klienti refuzon të kryejë pagesën"*.

Zyra e Komisionerit gjithashtu sjell në vëmendje kreun IV të këtij udhëzimi, "Kopjimi i kartave të identitetit apo dokumentave të udhëtimit" i cili shprehet:

*"Kopjet të kartave personale të identitetit apo dokumentit të udhëtimit, pasaportës, të grumbulluara dhe/ose të marra, mund të përpunohen vetëm nëse klienti të cilit i janë lëshuar këto dokumente, ka shprehur qartë me shkrim pëlqimin e tij, sipas aneksit 1 të këtij udhëzimi, si dhe me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet nga ana e organeve publike, të cilët e kanë këtë të drejtë nga legjislacioni në fuqi.*

*Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij".*

Konstatimet e mësipërme konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kritereve që parashikon Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Grumbullimi dhe ruajtja e përhershme e të dhënave të klientëve, nëpërmjet dokumentave identifikuese, duke krijuar një gamë të dhënash të përhershme, përbën shkelje serioze.

Për sa më sipër Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërmat "b", "d" dhe "dh" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, janë serioze dhe si të tilla, këto shkelje përbëjnë "kundërvajtje administrative", të cilat sanksionohen me gjobë.

Kontrolluesi Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategorinë "klient".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 18, 21, 27, 28, 39 pika 1, gërmat "b", "d", "dh" si dhe nenit 39, pika 2 e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

2. Dënimin e kontrolluesit Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **100.000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të realizojë njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale.
5. Kontrolluesi, Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të marrë masat për informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave të tyre personale.
6. Kontrolluesi, Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të marrë masat për shkatërrimin e të dhënave personale të grumbulluara në mënyrë të paligjshme.
7. Kontrolluesi, Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, brenda një periudhe 10 (dhjetë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të marrë masat për hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe pajisjen e punëmarrësve me deklarata konfidencialiteti.
8. Kontrolluesi, Hotel "SKY" sh.p.k. Tiranë, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky akt.
9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 9.11.2016

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**